



Lajmet e Fundit:

DVP Fier – Arrestohet në flagrancë 1 shtetas, procedohet penalisht 1 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër



LajmetOperacionet

17/03/2022

Lezhë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Blindi”

Kontrolle të befasishme në të gjithë qarkun, për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri, me qëllim parandalimin e krimeve ndaj personit dhe pronës.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Blindi”, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Lezhë.

Qarkullonte me automjet të blinduar dhe me armë zjarri me vete, vihet në pranga 23-vjeçari me precedent kriminal në fushën e krimeve ndaj personit.

Sekuestrohen armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe një automjet i blinduar.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas, me precedent kriminal, po qarkullonte me armë zjarri në një automjet të blinduar, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor “Blindi”.

Në kuadër të këtij operacioni, në Shëngjin, Lezhë, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dhe ndaluar mjetin e dyshuar dhe kanë vënë në pranga drejtuesin e tij, shtetasin K. V., 23 vjeç, banues në Fushë-Kuqë, Kurbin.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip “Benz”, në sendiljen e pasme, brenda një çante dore, shërbimet Policisë kanë gjetur një armë zjarri pistoletë dhe një sasi municioni luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin.

Materialet hetimore u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)



Share



Share



Share



Share



Email

◀ Raporti ditor i ngjarjeve, Policia e Shtetit, 17 mars 2022

Elbasan – Arrestohen në flagrancë 5 shtetas, për vepra të ndryshme penale ▶